

**UNIVERSITETI "NËNË TEREZA" NË SHKUP**  
**THIRRJE PËR APLIKIM**  
**NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS +**  
**KOMPONENTA KA103: MOBILITET INDIVIDUAL PËR STUDENTË DHE STAF**  
**për vitin akademik 2020/2021**

Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare ju informon se është hapur thirrja për aplikim për bursa për mobilitet në semestrin pranveror 2020-2021, në kuadër të programit Erasmus + të Komisionit Evropian.

Për shkëmbim të studentëve në **ciklin e parë** të studimeve, studenti duhet të ketë të paktën **60 ECTS**. Për **ciklin e dytë**, studenti duhet të jetë në vitin e pestë akademik të arsimit të tij / saj.

Kohëzgjatja e mobilitetit për studentët: **Një semestër**

Kohëzgjatja e mobilitetit për staf: **1 javë (deri në 5 ditë pune).**

Mobiliteti realizohet në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruara të Erasmus + në mes të UNT dhe universiteteve partnere në BE.

#### **1. Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët:**

- Formulari i Aplikimit për Studentë (të plotësohet nga studenti, faqja e tretë me koordinatorin e fakultetit)
- Certifikata e gjuhës angleze (minimum niveli B2)
- Certifikata e notave - Në gjuhën Angleze
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze)
- Letër rekomandimi (nga profesorët tuaj)
- CV (modeli Europass).

#### **Granti për mobilitet**

Shuma e bursës së siguruar nga programi Erasmus + për studentë është 450-500 EUR në muaj, në varësi të vendit të qëndrimit. Shpenzimet e udhëtimit dhe kostot e sigurimit shëndetësor nuk janë të mbuluara nga granti i Erasmus +.

#### **2. Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin:**

##### **Mobilitet për angazhim në mësimdhënie:**

- (Formulari i Aplikimit për Staf);
- Ftesë nga Universiteti pritës;
- CV (modeli Europass).

##### **Mobiliteti për trajnim:**

- (Formulari i Aplikimit për Staf);
- Vërtetim i njohjes së gjuhës angleze
- Ftesë nga Universiteti pritës;
- CV (modeli Europass).

Përzgjedhja / renditja e kandidatëve bëhet nga komisioni në përputhje me kriteret e përcaktuara: suksesin akademik, njohjen e gjuhës angleze ose gjuhën në të cilën kryhet mësimi dhe motivimin.

Për realizimin e mobilitetit studentët duhet të zgjedhin një nga universitetet nga lista e **Marrëveshjeve ndër-institucionale Erasmus +**. <http://unt.edu.mk/wp-content/uploads/2019/11/Erasmus-Partners.pdf>

**Për shkak të situatës aktuale dhe protokolleve për Covid-19, dokumentet mund t'i dërgoni në emailin: [amantin.qamili@unt.edu.mk](mailto:amantin.qamili@unt.edu.mk), jo më vonë se data 30 dhjetor 2020.**

Për informacion shtesë, studentët mund t'i referohen **Doracakut për Aplikim në Erasmus +** në lidhjen e mëposhtme: (<http://unt.edu.mk/wp-content/uploads/2019/11/Erasmus-Guidelines-Studies.pdf>); gjithashtu plotësoni formularin e **aplikimit online** në linkun: <https://forms.gle/XC2sC35LHgDxSTKa9>.

Formularët e aplikimit mund t'i shkarkoni në web faqen e universitetit [www.unt.edu.mk](http://www.unt.edu.mk).

Për informacion të mëtejshëm për studentët, ju lutemi kontaktoni:

Amantin Qamili, Koordinator Institucional – Erasmus +, zyra 515, email: [amantin.qamili@unt.edu.mk](mailto:amantin.qamili@unt.edu.mk)

Arbër Jashari, Koordinator i Erasmus, zyra 515, [arber.jashari@unt.edu.mk](mailto:arber.jashari@unt.edu.mk)

Edona Vinca, Koordinaore - Fakulteti i Studimeve Teknike - [edona.vinca@unt.edu.mk](mailto:edona.vinca@unt.edu.mk)

Arta Bekteshi, Koordinaore - Fakulteti i Informatikës, [arta.bekteshi@unt.edu.mk](mailto:arta.bekteshi@unt.edu.mk)

Kaltrina Zekolli, Koordinaore - Fakulteti i Shkencave Sociale, [kaltrina.zekolli@unt.edu.mk](mailto:kaltrina.zekolli@unt.edu.mk)

Zimere Musliji, Koordinaore - Fakulteti i Shkencave Teknologjike, [zimere.muslijie@unt.edu.mk](mailto:zimere.muslijie@unt.edu.mk)

Radmila Tomovska, Koordinaore - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, [radmila.tomovska@unt.edu.mk](mailto:radmila.tomovska@unt.edu.mk)

Në pritje të aplikimeve tuaj

Me respekt,

Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare,  
Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup

